

VENDIM
Nr. 344, datë 23.12.2025

**MBI RAPORTIMIN NË ERE TË INFORMACIONIT PËR SIGURIMIN E
ASETEVE DHE TË JETËS, DHE SHËNDETIT TË PUNONJËSVE NGA
SUBJEKTET E LICENCUARA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 99, datë 17.6.2016; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme me nr. 3122 prot., datë 22.12.2025, “Mbi raportimin në ERE të informacionit lidhur me sigurimin e aseteve dhe të jetës dhe shëndetit të punonjësve nga subjektet e licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- ERE, në mbështetje të nenit 37, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është autoriteti përgjegjës për lëshimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të licencave në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, është miratuar licenca tip për prodhimin e energjisë elektrike, e cila në pikën 2.5 parashikon detyrimin e të licencuarve për të siguruar jetën dhe shëndetin e njerëzve, si dhe asetet që shërbejnë për ushtrimin e aktivitetit, jo më vonë se 30 ditë nga lëshimi i licencës.

- Detyrimi për sigurimin e aseteve dhe të punonjësve është parashikuar, gjithashtu, edhe në kontratat e nënshkruara ndërmjet subjekteve prodhuese dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e autoritetit kontraktor, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centraleve gjeneruese të energjisë elektrike.

- Pika 3.2.2 e licencës për prodhimin e energjisë elektrike parashikon detyrimin e të licencuarve për të paraqitur pranë ERE-s, deri më 31 janar të çdo viti, raportin vjetor lidhur me operimet e tyre gjatë vitit kalendarik të mëparshëm.

- Në këto kushte, vlerësohet e nevojshme përcaktimi i një afati të unifikuar për raportimin pranë ERE-s të informacionit lidhur me përmbushjen e detyrimit për sigurimin, me qëllim disiplinimin e praktikës së raportimit, rritjen e transparencës dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit të zbatimit të kushteve të licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Afati për raportimin në ERE, lidhur me sigurimin sipas përcaktimeve të kontratës për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centraleve gjenerues të energjisë elektrike dhe kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike do të jetë data 31 janar e çdo viti.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë të gjitha subjektet e licencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për

gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti